



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/L1-11 Prot.
Nr. Dok. 202502506/11

Tiranë 06/08/2025

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për t'i vënë në dispozicion menjëherë prokurorit dhe gjykatës së shkallës së parë, vendimin penal të përmbledhur, në mënyrë që të ekzekutohet sa më parë si dhe marrja e masave për arsyetimin e vendimit brenda afatit ligjor ose brenda një afati të arsyeshëm.*

GJYKATËS SË AELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË

Për dijeni:

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
Tiranë

KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË
Tiranë

MINISTRISË SË DREJTËSISË
Komisionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale
Tiranë

Të nderuar,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë¹ i burgosuri L. M., i cili pretendon se duhet të ishte liruar nga burgu si përfitues nga Ligji Nr.33/2024 “Për dhënie amnistie”, pasi dënimi i dhënë ndaj tij, me 5 vite burgim, kishte marrë formë të prerë në datën 15.02.2023, por ai vazhdonte të mbahej i burgosur.

¹ Kjo ankesë është adresuar më 1 Mars 2025.

Ky i burgosur shpjegonte se për këtë ankesë kishte marrë përgjigje nga: Drejtuesi i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me shkresën Nr. K 495/1 Prot., datë 15.05.2024; Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën Nr. 1178/1 Prot., datë 15.05.2024; dhe Ministria e Drejtësisë me shkresën Nr. L-103 Prot., datë 21.05.2024, ku i kërkohej Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të vlerësonte nëse ai përfitonte nga amnistia.

Pasi u njohëm me këtë çështje, referuar nenit 13, paragrafi i parë, të Ligjit nr.8485, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”*, vlerësuam se ajo përmban elemente për t’u pranuar për shqyrtim nga ana e institucionit tonë.

Për verifikimin e kësaj ankese kemi marrë fillimisht informacion nga I EVP Jordan Misja, Tiranë, ku ndodhej i paraburgosur shtetasi L. M.

Referuar informacionit që na ka dhënë I EVP Jordan Misja, me shkresën Nr. 2272/1 Prot., datë 04.04.2025, rezulton sa më poshtë vijon:

- Shtetasi L. M. është arrestuar në datën 23.04.2021 dhe është pranuar në I EVP Jordan Misja, në datën 27.04.2021, pasi ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal “Arrest në burg”;
- Me Vendimin nr. 1760, datë 28.06.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ky shtetas është dënuar me 5 vite burgim, për kryerjen e veprës penale “Mashttrim”, parashikuar në nenin 143/3 të Kodit Penal;
- I EVP Jordan Misja, i është drejtuar me disa shkresa², institucionit tuaj, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Prokurorisë pranë kësaj gjykate, për t’u informuar nëse kishte marrë formë të prerë vendimi për shtetasin L. M. dhe nëse kishte dalë urdhri i ekzekutimit të vendimit penal, kërkonte t’i viheshin në dispozicion aktet përkatëse.
- Institucioni juaj, ka njoftuar I EVP-në, se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shtetasin L. M., është lënë në fuqi me Vendimin nr. 84, datë 15.02.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, por vendimi penal i formës së prerë nuk ishte arsyetuar dhe nuk ishte dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës³;
- Edhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë⁴ dhe Prokuroria pranë kësaj gjykate⁵, i kanë kthyer përgjigje I EVP-së, se nga

² Shkresat: Nr.1972 Prot., datë 22.05.2024; Nr.2485/1 Prot., datë 28.06.2024; Nr. 4337 Prot., datë 10.10.2024; Nr. 2326 Prot., datë 27.03.2025.

³ Shkresat: Nr. 12704/1 Prot., datë 21.06.2024; Nr.19086/1 Prot., datë 24.10.2024; Nr.7181/1 Prot., datë 16.04.2025.

⁴ Shkresat: Nr.2770/1 Prot., datë 27.08.2024; Nr. 3370/1 Prot., datë 22.10.2024; Nr. 1110/1 Prot., datë 08.04.2025; Nr.1182/1 Prot., datë 10.04.2025.

⁵ Shkresat: Nr.14412 Prot. A.N., datë 05.08.2024; Nr.1302/2 Prot., datë 15.04.2025.

verifikimet e kryera, nuk ishte dorëzuar për ekzekutim, vendim penal i formës së prerë për këtë shtetas;

- Në mungesë të vendimit penal të formës së prerë dhe urdhrit të prokurorit, për ekzekutimin e vendimit penal, IEVP-ja nuk ka aplikuar Ligjin nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie”, ku përfitimi është kushtëzuar me faktin e të qenit i dënuar brenda datës 31.03.2024.

Në vijim të shqyrtimit të këtij rasti, i jemi drejtuar gjykatës tuaj me dy shkresa⁶ për t’u informuar nëse ishte arsyetuar vendimi penal për shtetasin L. M. dhe cila ishte arsyeja e vonesës në arsyetimin e këtij vendimi. Gjithashtu, kemi kërkuar të informohemi nëse i është vënë në dispozicion prokurorit, vendimi penal i përmbledhur, sipas parashikimit të Kodit të Procedurës Penale dhe të Ligjit nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Deri aktualisht, nuk kemi marrë një përgjigje.

Gjithashtu, i jemi drejtuar me dy shkresa⁷ edhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për t’u informuar nëse kishte dalë urdhri i ekzekutimit të vendimit penal për shtetasin L. M., dhe nëse gjykata i kishte dërguar, vendimin e përmbledhur të formës së prerë.

Në përgjigjen që na ka kthyer Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën Nr.14746 Prot. M.Xh., datë 18.06.2025, jemi vënë në dijeni se: vendimi penal i formës së prerë për shtetasin L. M., është adresuar në këtë prokurori, nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, në datën 26.05.2025 dhe është protokolluar në datën 28.05.2025. Me shkresën Nr. 1302/1 Prot., datë 29.05.2025, Prokuroria Tiranë, i ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, urdhrin e ekzekutimit të vendimit penal, për të dënuarin L. M.

Në këto rrethana, kemi kontaktuar me përgjegjësin e sektorit ligjor të IEVP Fushë-Krujë, ku ishte transferuar ndërkohë i dënuari L. M., i cili na informoi se, urdhri i prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal, ka mbërritur në IEVP Fushë-Krujë në datën 29.05.2025, dhe po në këtë datë, drejtori IEVP-së ka urdhëruar lirim të dënuarit, pasi është konstatuar se ai kishte plotësuar dënimin me 5 vjet burgim. Gjithashtu, sipas llogarive që ka bërë sektori ligjor i IEVP Fushë-Krujë, rezulton se shtetasi L. M. ka kryer 2 (dy) ditë më shumë burgim.

Vlerësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit

Nga sa parashtruam më lart rezulton se, vendimi penal i formës së prerë, në ngarkim të shtetasit L. M., është dorëzuar i arsyetuar në kryesekretarinë e Gjykatës së Apelit të

⁶ Shkresat Nr.K2/L1-6 Prot., datë 16.04.2025 dhe Nr.K2/L1-8 Prot., datë 23.05.2025.

⁷ Shkresat Nr. K2/L1-5 Prot., datë 16.04.2025 dhe Nr.K2/L1-7 Prot., datë 23.05.2025.

Juridiksioni të Pëgjithshëm Tiranë, rreth 2 vite e 3 muaj, pasi është shpallur në seancën gjyqësore të datës 15.02.2023.

Ndërkohë, evidentojmë se bazuar në nenin 430/1, pika 4 të Kodit të Procedurës Penale⁸, vendimi penal, kur shpallet i përmbledhur nga gjykata apelit, arsyetohet brenda 30 ditëve nga shpallja e tij.

Në këtë rast, vendimi penal i formës së prerë është arsyetuar edhe në tejkalim të afatit të arsyeshëm që ka vendosur Inspektori i Lartë i Drejtësisë, duke patur parasysh ngarkesën në punë të gjyqtarëve.

Në raportin tematik të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të Shtatorit 2023⁹, është analizuar situata faktike në gjykata, nga ku ka rezultuar se 89% e vendimeve janë arsyetuar brenda një afati 120 ditor, ndërkohë që brenda afatit ligjor të përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile e Penale, rezulton 41% e vendimeve. ILD ka arritur në përfundimin se duke vlerësuar ngarkesën në punë të gjyqtarëve, numrin e reduktuar të tyre në detyrë, kapaciteteve dhe mundësive aktuale përfshirë dhe ato infrastrukturore, afatin 120 ditorë për arsyetimin e vendimit do ta konsiderojë si një afat të arsyeshëm që i nevojitet gjyqtarit. Në këtë përfundim ILD arrin, përsa i përket qëndrimit që ky Institucion duhet të mbajë në raport me përgjegjësitë disiplinore që propozohen ndaj magjistratëve, të cilët nuk kanë respektuar afatet e arsyetimit të vendimeve të përcaktuara në ligj, kjo dhe në referim të jurisprudencës së Gjykatës së Lartë¹⁰.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar edhe më parë, se në gjykata të ndryshme të vendit ka vonesa që shkojnë në disa muaj, e në disa raste me vite, për dorëzimin e vendimeve të arsyetuara në sekretari dhe më pas njoftimin e tyre palëve ndërgjyqëse.

⁸Neni 430/1

1. Vendimi shpallet në seancë nga kryetari ose një anëtar i trupit gjykues me anë të leximit të dispozitivit.
2. Pas dispozitivit kryetari lexon vendimin e arsyetuar. Arsyetimi i vendimit mund të jepet me shkrim edhe në mënyrë të përmbledhur, duke treguar shkaqet kryesore mbi të cilat bazohet vendimi. Në këtë rast gjykata u jep palëve në seancë vendimin e përmbledhur me shkrim.
3. Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas shpalljes. Nëpunësi i caktuar vë nënshkrimin dhe shënon datën e depozitimit.
4. **Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet brenda 30 ditëve nga shpallja e tij.** Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
5. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikës 4, të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës.

⁹<https://ild.al/sq/2023/10/04/raport-i-inspektimit-mbi-proceduren-e-shpalljes-dhe-arsyetimit-te-vendimeve-gjyqesore-te-gjykates-se-shkalles-se-pare-te-juridiksionit-te-pergjithshem-tirane-dhoma-civile-dhe-gjykates-administrat/>.

¹⁰ Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.5 datë 12.12.2013.

Çështja me palë: paditëse N.T, i paditur KLD, me objekt padi: Kundërshtim vendimi i KLD-së për shkarkimin e paditësit nga detyra e gjyqtarit.

Zbatimi i reformës në drejtësi, ka rritur ngarkesën e punës së gjyqtarëve në të gjitha nivelet e gjykatave në shkallë vendi, për shkak të mungesave dhe largimeve të një numri të konsiderueshëm gjyqtarësh dhe moszëvendësimit të tyre me të rinj.

Miratimi i reformës në drejtësi dhe zbatimi i saj duhet të garantojnë qëllimin dhe të përmbushin nevojat e shoqërisë tonë për funksionimin e shtetit të së drejtës, arritjen e pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi. Por, zvarritja e proceseve gjyqësore me muaj e madje me vite të tërë, ka cenuar të drejtën për akses në drejtësi dhe drejtësinë pa vonesa.

Ndërkohë, e gjejmë me vend të theksojmë rëndësinë e respektimit të parimit sipas së cilit gjykata duhet të realizojë një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, për të garantuar kështu të drejtat kushtetuese e ligjore të qytetarëve.

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor është një ndër të drejtat themelore. Për këtë arsye, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk është dhe nuk duhet të mbetet një e drejtë apo garanci deklarative, por është një standard kushtetues, i garantuar dhe i sanksionuar në aktet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në nivel ndërkombëtar respektivisht në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ashtu edhe në të drejtën e brendshme në nenin 42¹¹ të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Sjellim në vëmendje edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në jurisprudencën e saj, e cila në disa vendime ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, garantohet nga neni 42 i Kushtetutës (shih vendimet nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.12. datë 05.03.2012 ka arsyetuar se: *“Arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke patur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuarin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit”*. Gjykata Kushtetuese ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Arsyetimi i vendimit është një element thelbësor i një vendimi të drejtë.

¹¹ Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se:

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 6 “*E drejta për një proces të rregullt*”, i KEDNJ-së zë një vend të rëndësishëm në tërësinë e të drejtave që garanton kjo konventë. Një proces i rregullt ligjor në çështje civile dhe penale është një element bazë i parimit të shtetit të së drejtës. Midis garancive që lidhen direkt ose indirekt me gjykatën janë ndër të tjera: publiciteti i gjykimit (seancat e hapura dhe shpallja e vendimit publikisht), mënyra e zhvillimit të rregullt të seancave gjyqësore, konkretisht elementë të tillë si: barazia e armëve, afati i arsyeshëm, arsyetimi i vendimeve, etj.

Në referim të vendimeve të GJEDNJ¹², por edhe praktikës së saj në përgjithësi “*case law*”, gjykatat vendase kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm “*të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*”. Periudha e arsyeshme që merret në konsideratë për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor fillon me ngritjen e padisë dhe përfundon kur vendimi i arsyetuar merr formë të prerë.

Vonesa në arsyetimin e vendimit penal, sjell pengesa për të dënuarin për të ushtruar në mënyrë të efektshme të drejtën e rekursit, për të kaluar nga regjimi i paraburgimit në regjimin e të dënuarve, për t’u transferuar në një IEVP më afër vendbanimit të familjes, për të marrë takim me familjarët pa miratim paraprak të prokurorit, për të përfutur ulje dënimi për sjellje të mirë, për të përfutur leje shpërblyese, për të përfutur nga amnistia dhe për të bashkuar dënimet apo edhe për t’u liruar me plotësimin e dënimit.

Në rastin konkret, vonesa në arsyetimin e vendimit për shtetasin L. M., jo vetëm e ka privuar atë nga mundësia për të përfutur nga amnistia, ulja e dënimit për sjellje të mirë, por edhe ka sjellë si pasojë mbajtjen e tij në burg, **2 ditë më shumë se dënimi që ka marrë.**

Ky shtetas ka qëndruar në regjimin e paraburgimit, në pritje të arsyetimit të vendimit penal të formës së prerë. Ndërsa, prokurori i ekzekutimit të vendimit penal, ka llogaritur kohën e paraburgimit, sipas nenit 57 të Kodit Penal¹³, nga data e arrestimit të shtetasit L. M. e deri në datën kur është shpallur vendimi penal, dhe jo deri në datën kur vendimi është arsyetuar. Pra, data kur vendimi ka marrë formë të prerë është konsideruar, data e shpalljes së vendimit penal dhe jo data e arsyetimit të tij.

¹² PGV kundër Italisë, vendimi i GJEDNJ, datë 7.11.2000; **Çështja X kundër Francës, 1998**; Vocaturo kundër Italisë; Cappello kundër Italisë; Darvan kundër Turqisë, 2009; Zimmermann dhe Steinner kundër Zvicrës, datë 13.06.1983; Vendimi K.Klitshe de la Grande kundër Italisë, 27.10.1994; Poiss kundër Austrisë, datë 23.04.1097.

Vendimi “Hadjianastassiou kundër Greqisë, 16.12.1992

¹³ Neni 57 (**Llogaritja e paraburgimit**)

Koha e paraburgimit llogaritet në dënimin me burgim ose me gjobë, si dhe në detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik si më poshtë:

Një ditë paraburgim baras me një ditë e gjysmë burgim.

Një ditë paraburgim baras me 5 mijë lekë gjobë.

Një ditë paraburgim baras me tetëmbëdhjetë orë pune në interes publik.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka parasysh faktin se në gjykata aktualisht ka një numër të konsiderueshëm të çështjeve të paraqitura për gjykim, gjë që çon në ngarkesë voluminoze të punës së gjyqtarëve, por nga këndvështrimi i Avokatit të Popullit kjo barrë kurrsesi nuk mund t'u ngarkohet shtetasve.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vijimësi sa i përket procesit të rregullt ligjor, në koherencë me zbatimin e reformës në drejtësi është shprehur se: “... në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse”¹⁴.

Çmojmë se, gjykimi i çështjeve në kohë, arsyetimi i vendimeve, si dhe dorëzimi i tyre brenda afateve procedurale, apo kufirit të arsyeshëm, nevojitet të adresohen. Në këtë rast, konstatojmë se është cënuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Gjithashtu, në përfundim të hetimit administrativ të këtij rasti, rezulton se nuk është respektuar detyrimi ligjor i gjykatës, për t'i vënë në dispozicion prokurorit dhe gjykatës së shkallës së parë, vendimin e përmbledhur të formës së prerë, në zbatim të nenit 428, pika 2 dhe nenit 430/1 të Kodit të Procedurës Penale si dhe nenit 64, shkronja (a), të Ligjit nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Nëse i referohemi Kodit të Procedurës Penale (neni 428 dhe 430/1), shpallja e vendimit ndodh në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe përfaqëson deklarin e rezultatit të gjykimit. Ky akt është i rëndësishëm për vënien në ekzekutim të vendimit, dhe për këtë arsye, në rastet kur vendimi nuk shpallet i arsyetuar, ai u jepet palëve i përmbledhur me shkrim, në seancën e vendimit si dhe i njoftohet menjëherë gjykatës së shkallës së parë.

Më konkretisht, në nenin 428, të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet se:

“1. Gjykata e apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos:

a) lënien në fuqi të vendimit;

b) ndryshimin e vendimit;

c) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes kur janë rastet që nuk lejojnë fillimin ose vazhdimin e procedimit;

ç) prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete, me numrin e gjyqtarëve që është i domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod, me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, me pjesëmarrjen e të pandehurit, të mbrojtësit të tij, ose përfaqësuesit të viktimës akuzuese, me shkeljen e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja, si dhe në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit.

¹⁴ Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 03.10.2023, pika 21, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 162, datë 09.11.2023.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet menjëherë gjykatës së shkallës së parë.”

Po ashtu, në nenin 430/1, të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet se:

- 1. Vendimi shpallet në seancë nga kryetari ose një anëtar i trupit gjykues me anë të leximit të dispozitivit.***
- 2. Pas dispozitivit kryetari lexon vendimin e arsyetuar. Arsyetimi i vendimit mund të jepet me shkrim edhe në mënyrë të përmbledhur, duke treguar shkaqet kryesore mbi të cilat bazohet vendimi. Në këtë rast gjykata u jep palëve në seancë vendimin e përmbledhur me shkrim.***
- 3. Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas shpalljes. Nëpunësi i caktuar vë nënshkrimin dhe shënon datën e depozitimit.***
- 4. Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.***
- 5. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikës 4, të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës***

Ligji Nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” përcakton subjektet përgjegjëse për ekzekutimin e vendimit penal dhe afatet e veprimeve që këto subjekte duhet të kryejnë.

Sipas detyrimit ligjor, prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë, pas administrimit të vendimit përmbledhës për dënimet me burgim, duhet të kryejë veprimet paraprake për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit (neni 64, shkronja “a” i Ligjit Nr.79/2020 parashikon se: ***“Prokurori kryen veprimet paraprake dhe nxjerr urdhrin e ekzekutimit: a) për dënimet me burgim ose mjekim të detyrueshëm në institucionet mjekësore, me të paraburgosur, menjëherë pas marrjes së përmbledhjes së vendimit”***).

Në kushtet e sistemit tonë gjyqësor, ku për shkak të ngarkesës me çështje të gjyqtarëve, vendimet penale po arsyetohen tej afateve ligjore dhe atyre të arsyeshme, merr rëndësi të veçantë zbatimi i detyrimit ligjor, nga ana e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për t’i vënë në dispozicion menjëherë prokurorit dhe gjykatës së shkallës së parë, përmbledhjen e vendimit penal të formës së prerë, në mënyrë që të ekzekutohet sa më parë dhe të shmanget shkelja e të drejtave të personave të dënuar me burgim.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”.

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave për t'i vënë në dispozicion menjëherë prokurorit dhe gjykatës së shkallës së parë, përmbledhjen e vendimit penal të formës së prerë, në mënyrë që të ekzekutohet sa më parë.
- Marrjen e masave për arsyetimin e vendimit penal brenda afatit ligjor, dhe në çdo rast jo tej afatit të arsyeshëm të përcaktuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në varësi të ngarkesës në punë të gjyqtarëve.
- Adresimin e problematikës së mungesës së kapaciteteve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditë, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Besnik DEDA

D.V